

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Fier**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 63, datë 29.05.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1201/6, datë 29.05.2015, i ka rekomanduar z.Baftjar Zeqo, Kryetar i Bashkisë Fier, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për zbatimin e detyrave të rekomanduar me shkresën nr. 1016/25, datë 30.06.2014, rezulton se disa rekomandime nuk janë zbatuar plotësisht ose janë në proces zbatimi, veprime në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, konkretisht:

- nga 22 masa organizative me vlerë 110,609,624 lekë, nuk kanë gjetur zbatim të plotë ose zbatuar pjesërisht 8 masa me vlerë 67,246,104 lekë;
- nga 9 masa shpërblim dëmi me vlerë 63,630,534 lekë, nuk kanë gjetur zbatim të plotë ose zbatuar pjesërisht 3 masa me vlerë 62,881,274 lekë;
- nga 23 masa disiplinore nuk është zbatuar asnjë masa disiplinore .

Rekomandimi: Nga Bashkia Fier të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të pa zbatuara plotësisht ose pjesërisht për;

- 8 masa organizative me vlerë 67,246,104 lekë;
- 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 62,881,274 lekë;
- 23 masa disiplinore;

Për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet KLSH^{ja} si për afatin e caktuar, por dhe pas 6 muajve të informohet KLSH^{ja}, në zbatim të nenit 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe nenit 30, pika 2 e këtij ligji.

. Gjetje nga auditimi: Struktura organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Fier, nuk janë në përputhje me lidhjen 4, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin njësisive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar, dhe lidhjes nr. 4, të VKM nr. 598, datë 27.04.2009, i ndryshuar, pasi pagesa është bërë sipas kategorisë I-b me shtesë funksioni 55,000 lekë/muaj, ndërkohë që duhej bërë sipas kategorisë II-b me shtesë funksioni 42,000 lekë/muaj.

Rekomandimi: Drejtoria e Legjislacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, të marrë masa që në mbledhjen më të afërt të Këshillimit Bashkiak, të propozojë ndryshimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Fier, sipas dispozitave ligjore.

3. Gjetje nga auditimi: Gjendja e debitorëve nga 82,000,564 lekë në fund të vitit 2013, në fund të vitit 2014 paraqitet në shumën 57,435,431 lekë.

Megjithëse nga ana e titullarit janë nxjerrë urdhrat në emër të personave për arkëtimin e detyrimeve të kontabilizuar, nga Drejtoria Ekonomike dhe Legjislacionit të Bashkisë, nuk është proceduar më tej për ndërhyrje në rrugë ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit në zbatim të germës “g”, të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” .

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Legjislacionit, të marrë masat për arkëtimin e debitorëve duke ndjekur të gjitha hapa ligjore për vlerën **57,435,431 lekë**, nga e cila; *detyrime të rekomanduar nga auditimet e mëparshme të KLSH për vlerën 12,297,467 lekë.*

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi regjistrimin e pronave të Bashkisë Fier, miratuar me VKM nr. 574, datë 28.5.2009, shtuar me VKM nr. 253 datë 31.3.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në Bashkinë Fier, të Qarkut Fier”, rezulton se nga 845 prona janë regjistruar në ZVRPP Fier gjithsej 106 prona. Për këto prona nuk është bërë vlerësimi ekonomik i objektit, por vetëm vlerësimi ekonomik i truallit me çmimin e truallit të përcaktuar me VKM, si dhe nuk janë kontabilizuar për vlerën reale të tyre.

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave, të marrë masa për;

- inventarizimin e të gjithë pronave të Bashkisë Fier, regjistrimin në ZVRPP dhe pasqyrimin në kontabilitet të vlerës reale të tyre, duke përgatitur regjistrin përkatës;
- indetifikimin e të gjitha pronave të zëna nga subjekte të tjerë dhe llogaritjen e detyrimeve për qiranë objektit/truallit ose zbatimin e procedurave ligjore për lirimin e tyre.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se me datë 31.12.2014 vlera e detyrimeve debitor ndaj Bashkisë Fier, paraqitet në vlerën **2,614,175 lekë**, nga e cila; *debitorët e biznesit të vogël për 34 subjekte në vlerën 1,213,656 lekë dhe debitorët e biznesit të madh për 15 subjekte në vlerën 1,400,519 lekë.*

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për arkëtimin e **49 subjekteve debitorë në vlerën 2,614,175 lekë**, nga e cila; biznesi i vogël për 34 subjekte me vlerë 1,213,656 lekë dhe biznesi i madh për 15 subjekte me vlerë 1,400,519 lekë, sipas pasqyrës Aneks 5 dhe 6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Fier ka privatizuar banesa në pronësi sipas VKM nr. 574, datë 28.05.2009 dhe VKM nr. 782, datë 14.11.2007 “Për kalimin e mjediseve të konviktit të shkollës së mesme “Petro Sota” Fier, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në pronësi të Bashkisë Fier”, për nevoja sociale banimi, *konkretisht:*

Me vendim të KB nr. 8, datë 27.01.2011 është miratuar për privatizim objekti “ish-hotel Vjosa” me sipërfaqe ndërtimi 600 m², për ambiente banimi në të cilën është miratuar lista për strehimin e 42 familje.

Me vendim të KB nr. 9, datë 31.01.2008 është miratuar për privatizim objekti “ish-konvikti i shkollës së mesme industriale “Petro Sota” me sipërfaqe ndërtimi 692 m², në ZK 8534 dhe pasurie nr. 4/40 “për miratimin e listës së familjeve që banojnë në këto ambiente”, gjithsej lista me 46 familje.

Nga dokumentacioni i audituar, rezulton se;

- mos arkëtim të detyrimeve që rrjedhin nga privatizimi i banesës ose likuiduar më pak sa përcakton VKM^{ja} nr. 97, datë 03.02.2008 “Procedurat e privatizimit të banesave”, në 4 familje për një vlerë prej 318,685 lekë.

Rekomandimi: Drejtoria e Legjislacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve nga privatizimi i banesave të **2 familjeve në shumën 297,276 lekë**, konkretisht:

1. J.L në shumën 137,281 lekë.

2. R.N në shumën159,995 lekë.

7. Gjetje nga auditimi: Kontrata nr. 1375/2, datë 27.12.2011 e lidhur midis Bashkisë Fier dhe subjektit “Internacional Parking 2011”, për kryerjen e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë ka mangësi dhe bie ndesh me dispozita ligjore, *konkretisht:*

-Afati i përcaktuar në kontratë është në kundërshtim me udhëzimin e ish-Ministrisë Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjekteve që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, nga 5 vjet në 20 vjet .

Rekomandimi: Bashkia Fier të revokojë kontratën e shërbimit të parkimit me pagesë nr. 1375/2, datë 27.12.2011, të lidhur me subjektin “Internacional- Parking 2011”, konkretisht pika 2.2 e nenit II të kontratës, nga afati 20 vjeçar të lidhet për afatin 5 vjeçar, pasi është në kundërshtim me pikën 4 të nenit 12, të udhëzimit nr. 7, datë 10.06.2008.

8. Gjetje nga auditimi: Mungesa e studimit të fezibilitetit të parkimit në rrugë, ka bërë që bashkia të mund të mos menaxhojë dhe përcaktojë nivelin e të ardhurave që duhet të arkëtojë

nga tarifa e parkimit me pagesë në rrugë të mjeteve, veprime në kundërshtim me germës “b” të pikës 3, të nenit 17 të udhëzimi nr. 7, datë 10.06.2008 ”Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të Parkimit me pagesë në Rrugë”.

-Mos përcaktimi i saktë i të ardhurave që bashkia duhet të marrë nga aktiviteti i shërbimit të parkimit në rrugë (30 % e fitimi Bashkia dhe 70% subjekti), përcaktuar në pikën 3 të nenin III-“Marrëdhëniet financiare mes palëve” të kontratës, është në kundërshtim me dispozitat e udhëzimi nr. 7, datë 10.06.2008 ”Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të Parkimit me pagesë në Rrugë”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 8458, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhura”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006“Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, të cilat kanë çuar në mos arkëtim të të ardhurave **shumën 4,290,506 lekë**.

-Mungesa e kontroleve të kryera në pasqyrat financiare të subjektit “I...P.....”, referuar pikës 5.4 të nenit V, të kontratës midis Bashkisë dhe subjektit, për saktësimin e të ardhurave .

Rekomandimi: Të kryhet studimi i fezibilitetit të parkimit të mjeteve në rrugë, në zbatim të germës “b” të pikës 3 e nenit 17, të udhëzimi nr. 7, datë 10.06.2008 ”Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të Parkimit me pagesë në Rrugë”, ku të përcaktohet niveli i të ardhurave vjetore që mund të realizohen nga ky shërbim dhe përqindja e të ardhurave që përfiton Bashkia nga tarifa e parkimit të mjeteve në rrugë me pagesë, duke ndryshuar pikën 3.1 e nenit III, të kontratës “Marrëdhëniet financiare mes palëve”, ku nga kriter fitim të vendoset kriteri i përqindjes mbi të ardhurat mujore të realizuara (sipas tarifës parkimit 50 lekë/ora).

9. Gjetje nga auditimi: Me vendim të KB nr. 9, datë 23.01.2014 është miratuar shtesë kontrate (nr. 1375/4, datë 03.03.2014) që aktiviteti i subjektit “I... P”, të menaxhohet nëpërmjet blloqeve të biletave dhe procesverbaleve të gjobave për parkim të gabuar dhe largimit të mjeteve, por nuk është përcaktuar menaxhimi i të ardhurave të përfituara .

Rekomandimi: Drejtoria e Legjislacionit të përgatisë materiali dhe të miratojë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, mënyrën e përdorimit të të ardhurave që subjekti përfiton nga procesverbalet e gjobave për parkim të gabuar dhe largimit të mjeteve.

10. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit nuk ka hartuar Rregulloret model të planifikimit, ku të përcaktohen rregulla të hollësishme, formatimi dhe projektet për kërkesa zhvillimi dhe inspektimin, sipas fazave të ndryshme të punimeve, në zbatim të Instrumenteve të kontrollit të cilat miratohen në këshillin e Bashkisë, veprim në mospërputhje me nenin 59 e 61, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrë masat, të hartojë rregulloret model të planifikimit duke përcaktuar rregulla të hollësishme, formatin dhe projektet për kërkesa zhvillim dhe inspektimin, sipas fazave të ndryshme të punimeve dhe të miratojë në këshillin e Bashkisë.

11. Gjetje nga auditimi: Këshilli Teknik nuk ka hartuar informacion i shkruar për Kryetarin e Bashkisë, për ta informuar për vlerësimin e kërkesave për leje zhvillimi ndërtimi, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Këshilli, për të cilat Kryetari i Bashkisë të jetë i informuar për vendimet që do të marrë në lidhje me lejet e zhvillimit për subjekte private dhe publike, veprim në mospërputhje me nenin 10, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe neni 45, të KVKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të territorit” .

Rekomandimi: Këshilli Teknik të marrë masa, të hartojë informacion me shkrim për Kryetarin e Bashkisë, për vlerësimin e kërkesave që ka shqyrtuar dhe vlerësuar për leje zhvillimi ndërtimi për subjekte private dhe publike.

12. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Fier nëpërmjet vendimi për ndërtim e Terminalit të Autobuzave Fier, ka miratuar leje infrastrukture, ndërsa duhet të ishte miratuar leje zhvillimi ndërtimi, veprim në mospërputhje me nenin 72, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe me nenin 6 e 13, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa, që vendimet për leje zhvillimi ndërtimi të jenë të përcaktuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

13. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në lejen e zhvillimit për ndërtimin e Terminalit të Autobuzave Fier, nuk ka plotësuar me dokumentacionin për marrëdhëniet me truallin dhe me Kontratë noteriale për pasurinë nr. 242/1, me sipërfaqe 15,000 m² truall, veprim në mospërputhje me nenit 72, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe me nenin 6 e 13, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit të marrë masa dhe të plotësojë me kontratë noteriale pasurinë nr. 242/1, me sipërfaqe 15,000 m².

14. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Fier në 19 raste, në vendimet për leje zhvillimi ndërtimi për strukturat ndërtimore ka të miratuar duke mos zbatuar distancat nga kufiri i pronës dhe strukturat e tjera, veprim në mospërputhje ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013, me shkronjën “e” neni 3, nenin 39 e 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe Rregulloren nr. 16, datë 10.05.2013 “Ndërvendore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Bashkinë Fier dhe një pjesë të Komunës Qendër”, miratuar nga KKTRSH .

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fier të marrë masa, që në vendimet e marra për leje zhvillimi ndërtimi për strukturat ndërtimore të zbatojë distancat nga kufiri i pronës dhe nga strukturat e tjera.

15. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Fier, për vitin 2014, në 17 raste, kërkesat e ardhura për leje zhvillimi dhe vendimet e Kryetarit të Bashkisë, nuk i ka hedhur në portalin Web të Regjistrimit të Territorit.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Fier, të marrë masa për të hedhur në portalin Web të regjistrimit të territorit të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ardhura për leje zhvillimi dhe vendimet e marra nga Kryetari i Bashkisë.

16. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Fier, për vitin 2013-2014 nuk ka bërë verifikimet e preventivit për zërat e punimeve hartuar nga subjekte private për leje zhvillimi ndërtimi për çmimet e punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, veprim në mospërputhje me VKM nr. 407, datë 27. 06.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Fier të marrë masa, të bëjë verifikimin e preventivit për zërat e punimeve hartuar nga subjekte private për leje zhvillimi ndërtimi me çmimet e punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

17. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Fier, për vitin 2013-2014, në 21 raste dokumentacionin tekniko ligjor i dërguar në ZVRPP Fier, e ka dërguar me mangësi, veprim në mospërputhje me kreun II, neni 9 dhe 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Fier, të marrë masa, që dosja e leje së përdorimit të plotësohet me dokumentacionin e duhur ligjor.

18. Gjetje nga auditimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në Bashkinë Fier, në 25 raste nuk ka arkëtuar gjoba shumë 6,400,000 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë, veprim në mospërputhje me nenin 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në Bashkinë Fier, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave në shumë 6,400,000 lekë, sipas pasqyrës nr. 5, bashkëlidhur Raporti Auditimit.

19 Gjetje nga auditimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në Bashkinë Fier, në 4 raste nuk ka ekzekutuar vendimet për prishjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi, veprim në mospërputhje paragrafin 3 të nenit 13, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në Bashkinë Fier, të marrë masa dhe të ekzekutojë vendimet për prishjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi, sipas pasqyrës në faqen 140, të Raporti Auditimi.

20. Gjetje nga auditimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në Bashkinë Fier, në 22 raste për firmat e ndërtimit dhe subjekte private të cilët kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, nuk ka kryer kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, veprim në mospërputhje me shkronjën “dh” të

nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe me pikën 1 e 2 të nenit 81, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar .

Rekomadimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në Bashkinë Fier, të marrë masa dhe të dërgojë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, 22 firmat e ndërtimit dhe subjekte private të cilët kanë ndërtuar pa leje ndërtimi.

21. Gjetje nga auditimi: Drejtorja e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Fier, për periudhën 2013-2014, nuk ka kryer inventarizimin e çdo fletë në dosje, si dhe nuk është hartuar fletë inventari, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 93-132, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Drejtore e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Fier, të fillojë inventarizimin e dosjeve, duke hartuar edhe fletën e inventarit.

22. Gjetje nga auditimi: Për objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa” me vlerë të plotë të preventivuar 200,205,812 lekë me TVSh nuk është bërë oponenca teknike e preventivit të projektit në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, neni 6, Urdhrin Nr. 7, datë 20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe Vendimin nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” .

Rekomandimi:

a. Bashkia Fier të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësisë për mos kryerjen e oponencës teknike për objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa”, me vlerë të plotë të preventivuar 200,205,812 lekë me TVSh.

b. Bashkia Fier të marrë masa që në projektet e ardhshme të kryhet oponenca teknike e projektit për projektet me vlerë të preventivuar mbi 100,000,000 lekë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, gjatë viti 2014 janë shpërblyer për punë të mirë 6 punonjës për vlerën 354,600 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 905, datë 17.12.2014 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të nxjerrë urdhër për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së shpërblyer të dhënë në adresë të **6 punonjësve për vlerën 354,600 lekë**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni i bankës, konstatohet se Kryetari të Bashkisë z. B.Z, i është paguar përfitimi financiar mujor i shërbimit të transportit vlera **450,000 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, i ndryshuar, me nenin 1, të ligjit nr. 169/2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil” .

Rekomandimi: Drejtorja Ekonomike të marrë masa për kthimin e shumës prej **450,000 lekë** nga z. B.Z, Kryetari i Bashkisë, si përfitim i kundërligjshëm të shërbimit të transportit.

3. Gjetje nga auditimi: Drejtorja Ekonomike ka paguar nëpunës të Bashkisë si; Drejtore të Përgjithshme në kategorinë I-b me shtesë për pozicionin 55,000 lekë/muaj (viti 2013 gjithsej 8 persona dhe viti 2014 gjithsej 9 persona), por në fakt referuar vendimit të KB nr 47, datë 29.9.2009, duhet të paguheshin në kategorinë II-b, me shtesë për pozicionin 42,000 lekë/muaj, pra paguar më tepër për shumën 1,712,355 lekë, nga e cila; në vitin 2013 në shumën 896,444 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 815,911 lekë, veprime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në lidhjen 4, lidhen 2, kolona 5, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009 “Për një ndryshim të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008” .

Rekomandimi: Drejtorja Ekonomike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e pagës të përfituar padrejtësisht në shumën **1,712,355 lekë**, konkretisht; **vlera 107,562 lekë** në ngarkim *znj. A.Dh* ish-Drejtor i Përgjithshme i Drejtorisë Ekonomike; **vlera 241,176 lekë** në ngarkim të *z. F.T* me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike; **vlera 241,176 lekë** në ngarkim të *znj. E.Q* ish-Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike; **vlera 241,176 lekë** në ngarkim të *z. L.Ç* me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

të Legjislacionit; **vlera 307,368 lekë** në ngarkim të z. *Sh.K* me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore; **vlera 39,416 lekë** në ngarkim të *znj. P.B* si SNLnë Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; **vlera 59,124 lekë** në ngarkim të *znj. O.P* me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit dhe Inspektimit; **vlera 241,176 lekë** në ngarkim të *znj. R.H* me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; **vlera 97,806 lekë** në ngarkim të *znj. A.R* ish-Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore(viti 2014); **vlera 49,270 lekë** në ngarkim të *znj. M.K* me detyrë SNL në Drejtorinë e Koordinimit të Strategjive të Marketingut; **vlera 76,861 lekë** në ngarkim të z. *F.J* ish-Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore(viti 2014); **vlera 10,244 lekë** në ngarkim të *znj. M.H* ish-Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave (viti 2014).

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve me bankë të vitit 2014 në Ndërmarrjen e Pastrimit është evidentuar se në prokurimet me vlerë të vogël, blerjet janë kryer në subjekte të biznesit të vogël për të cilën është likuiduar TVSH^{ja} e fondit limit, veprime në kundërshtim me nenin 48, të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH^{ne}”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Ndërmarrja e Pastrimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës së TVSh së fondit limit në vlerën **36,024 lekë**, evidentuar në **2 subjekte, konkretisht:**

- **Vlera 30,027 lekë** në ngarkim të subjektit “A..K” me nipt K.....A

- **Vlera 5,997 lekë** në ngarkim të subjektit “Sh.... B me nipt K.....K.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të aseteve, rezulton se për dy objekte pronë e Bashkisë Fier, kaluar me VKM nr. 574, datë 28.5.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, të Qarkut Fier” dhe regjistruar në ZVRPP Fier në vitin 2012 (me çertifikatë pronësie), nuk është vepruar për lirim të tyre ose lidhjen e kontratave të qirasë me personat përdorues të tyre, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, me ndryshime, dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014 .

Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, të marrë masat për evidentimin e objekteve të zaptuara nga të tretë, duke saktësuar, kontabilizuar dhe arkëtuar detyrimet e qirasë së pallogaritur për periudhën e përdorimit të tyre, *konkretisht:*

-Për objektin “ish-magazina e farave”, për sipërfaqe ndërtimi 976 m², me detyrim të pallogaritur për qiranë në shumën **3,513,600 lekë**.

-Për objektin “ish-komunale Fshat, lagjja 15-Tetori”, për sipërfaqe ndërtimi 220 m² (me 2 kate), me detyrim të pallogaritur për qiranë në shumën **1,210,212 lekë**.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të objekteve të lëshuara me qira dhe likuidimeve të shumave përkatëse, rezulton se në 1 rast nuk janë llogaritur kamatëvonesat për mos likuidim në afat të detyrimeve për shumën 71,400 lekë, sipas kushteve të kontratës së qirasë nr. 2181rep/484kol, datë 24.04.2006 për sipërfaqe objekti 1584 m² dhe tarifë mujore 238,000 lekë/muaj .

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për llogaritjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e sanksioneve të parashikuara në kontratë të kamatëvonesave të pa aplikuar nga mos likuidimi në afat i detyrimeve të qiramarrësin “S....G” në shumën **71,400 lekë**.

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Fier në 2 raste, në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë ka llogaritur dhe arkëtuar më pak shumën **73,710 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiar me dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë, veprim në mospërputhje me pikën 2, të nenit 70/29, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 01.04.2013

Rekomandim: Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Fier të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën **73,710 lekë**, *si më poshtë:*

1- Për subjektin ndërtues “L..... F” shpk për objekt shërbim 2 kat + Pikë Karburanti + Autogaz, sa nuk janë llogaritur punimet e kryera për vendosjen e depozitave të karburantit nën tokën natyrale në vlerën **26,680 lekë**.

2- Për shoqërinë zhvilluese “R....i” shpk, sa llogaritur dhe arkëtuar më pak taksë e ndikimit në infrastrukturë për ndërtim objekte objekt 1 kat nëntokë + 1 kat shërbim + 6 kat në vlerën **47,030 lekë**.

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Fier ka privatizuar banesa në pronësi të saj, sipas VKM nr. 574, datë 28.05.2009 dhe VKM nr. 782, datë 14.11.2007 “Për kalimin e mjediseve të konviktit të shkollës së mesme “Petro Sota” Fier, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në pronësi të Bashkisë Fier”, për nevoja sociale banimi, *konkretisht:*

Me vendim të KB nr. 8, datë 27.01.2011 është miratuar për privatizim objekti “ish-hotel Vjosa” me sipërfaqe truall 600 m² dhe ndërtimi 600 m², për ambiente banimi në të cilën është miratuar lista për strehimin e 42 familje për banim.

Me vendim të KB nr. 9, datë 31.01.2008 është miratuar për privatizim objekti “ish-konvikti i shkollës së mesme industriale “Petro Sota” me sipërfaqe truall 692 m² dhe ndërtimi 692 m², në ZK 8534 dhe pasurie nr. 4/40 “për miratimin e listës së familjeve që banojnë në këto ambiente”, gjithsej lista me 46 familje.

Nga dokumentacioni i audituar, rezulton;

-mos ndjekjen e procedurave të privatizimit të objektit, për llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky privatizim për 19 raste me vlerë 3,328,780 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 13-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Drejtoria e Legjislacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave, të marrë masa për zbatimin e procedurave të mbetura nga privatizimi i objekteve “Ish-konvikti i shkollës së mesme industriale, Petro Sota” dhe “Ish-hotel Vjosa”, për **19 familjeve me vlerë 3,328,780 lekë**, konkretisht:

-Objekti “Ish-hotel Vjosa”, për **3 personat në vlerën 411,843 lekë**.

-Objekti “Ish-konvikti i shkollës së mesme industriale, Petro Sota”, për **16 persona në vlerën 2,916,937 lekë**(*lista në Raportin përfundimtar*).

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e tenderit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Andon Xoxa” Fier, zhvilluar sipas urdhër prokurimit me nr. 8, datë 15.8.2014, subjekti “B.....B” shpk ka tërhequr ofertën e vet.

Në këtë rast, nga Autoriteti Prokurues Bashkia Fier, nuk ishin ndjekur procedura ligjore për arkëtimin e vlerës së sigurimit të ofertës në shumën 568,264 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 49 germa “ii” dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu III pika 2, germa “e”.

Rekomandimi: Bashkia Fier të marrë masat, duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës së sigurimit të ofertës ndaj subjektit “B.....” shpk në **vlerën 568,264 lekë**, të siguruar në shoqërinë “A.....” sha, Tiranë.

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në 4 raste me vlerë kontrate 88,562,965 lekë (me tvsh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **36,137,315 lekë**. Vlerë kjo që përcaktohet në objektin; “Rikonstruksion i bulevardit “Jakov Xoxa” në vlerën 30,429,040 lekë dhe “Rikonstruksion i shkollës “Andon Xoxa” në vlerën 5,708,275 lekë, “Rikonstruksion i shkollës”, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar .

Rekomandimi: Bashkia Fier të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 4 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **36,137,315 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

D. MASA DISIPLINORE:

D/I. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fier, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga Shërbimi Civil**”, për **18 punonjësit** e Bashkisë Fier.

D/II. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me ndryshime, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “**Vërejtje**” deri në “**Zgjidhjen e Kontratës së Punës**”, për **4 punonjësit** e mëposhtëm:

1. Znj. E.Q, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Punëve Publike.

Për mangësi të konstatuara në:

Mos zbatimin e Rregullores “Për organizimin , funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së Bashkisë Fier”, Kapitulli VI, Neni 41-*Departamenti i Punëve Publike*, ku përcaktohen edhe detyrat përkatëse, *konkretisht:*

-Likuidimin e punimeve të pakryera për disa zëra ne dy kategori punimesh në objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa”;

-Likuidimin e punimeve mbi ato të parashikuara, të ofertuara dhe të miratuara nga vetë Titullari dhe projektuesi në objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa”;

-Dokumentacionin e dosjes teknike për objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa”

2. Znj. V.P, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në Ndërmarrje e Pastrimit.

Për shkeljet e konstatuara në:

-Likuidimin e vlerës së TVSH të fondit limit në shumën **36,024 lekë**, ndajë subjekteve të biznesit të vogël pa tvsh, veprime në kundërshtim me nenin 48, të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH^{nës}”, me ndryshime (*Trajtuar më hollësisht në faqen 151-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Z. F.M, me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, nga data 02.12.2013 e në vazhdim.

4. Znj. G.P, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Punëve Publike dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për mangësi të konstatuara në:

Mos zbatimin e Rregullores “Për organizimin , funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së Bashkisë Fier”, Kapitulli VI, Neni 41-*Departamenti i Punëve Publike*, ku përcaktohen edhe detyrat përkatëse, *konkretisht:*

-Likuidimin e punimeve të pakryera për disa zëra ne dy kategori punimesh në objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa”;

-Likuidimin e punimeve mbi ato të parashikuara, të ofertuar dhe të miratuara nga vetë Titullari dhe projektuesi në objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa”;

-Dokumentacionin e dosjes teknike për objektin “Rikonstruksion i rrugës Jakov Xoxa” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 73-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Shkeljet e rregullave të prokurimit publik, në tenderin me objekt “**Rikonstruksion i bulevardit Jakvo Xoxa**”, zhvilluar në vitin 2014.

-Të 5-të operatorët ekonomikë që kanë paraqitur ofertat e tyre, nuk i plotësojnë kushtet për kualifikim përfshi operatorin e shpallur fitues bashkimi i operatorëve “A.... Cons” dhe “A...a” shpk e cila në këtë rast, është me ofertë ekonomike me të madhe se sa operatorët e tjerë. **Në këtë rast, tenderi duhej të ishte anuluar.**

E. MASA ADMINISTRATIVE:

I. Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Fier, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për

rregullat e prokurimit publik”.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj 5 anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, *për të cilët janë marrë masa me gjobë 100 mijë lekë secili.*

E/II. Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 15, ndryshuar me nenin 2, të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7, pikat 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10, të Kreut II dhe pikat 4 dhe 5, të Kreut III të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Bashkia Fier, **të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë për subjektin “E...../M” sh.p.k**, me ing. Gëzim Goxhaj dhe ing. Fatbardha Goxhaj, nën cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderave nëpërmjet likuidimit të punimeve të pakryera, më konkretisht në tenderin **“Rikonstrukcion i rrugës Jakov Xoxa”**, për likuidimin e punimeve të pakryera në disa zëra për dy kategori punimesh në objektin, likuidimin e punimeve mbi ato të parashikuara, të ofertuara dhe të miratuara nga vetë Titullari dhe projektuesi, mangësi në dokumentacionin e dosjes teknike, veprime në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 1, nenin 7, pika 3, pika 4, pika 6 dhe pika 9 e kontratës së mbikëqyrjes nr. 4/122 – 231/2014 me nr. 1422/6 prot, datë 07.08.2014 lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier dhe Shoqërisë mbikëqyrëse “Ersi/M” sh.p.k ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësit të punimeve si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2, 3.3 dhe pika 4, paragrafi 4 .

Nga Bashkia Fier, është kthyer përgjigje me shkresë 1201/10, datë 29.06.2015 sëbashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Kristaq Gjuraj, Josif Lile, Përparim Gjuzi, Qemal Shehu dhe Julian Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT